



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-10

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 25 shtator 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Emri i dosjes:** Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës

**Klasifikimi:** Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

---

## VENDIM

mbi Kërkesën për Caktimin e Vendit të Procedurës në Shtetin Pritës

---

**Gjykatësit të Procedurës Paraprake:**  
Gjykatës Nikola Giju

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Vard Ferdinandse

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në përputhje me nenin 3(6), (8)(a) dhe (d) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pritës<sup>1</sup> dhe rregullën 82(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës për procedurat e filluara sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86 të Rregullores për të gjitha procedurat dhe çështjet e tjera që burojnë në lidhje me to.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shtator 2023, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar e njoftoi Kryetaren, në pajtim me rregullën 86(1) të Rregullores, për një aktakuzë që do të protokollohet dhe kërkoi caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit.

2. Më 11 shtator 2023, Kryetarja caktoi gjykatësin Nikola Giju si Gjykatës të Procedurës Paraprake në çështjen aktuale.<sup>2</sup>

3. Më të njëjtën ditë, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi Parashtrimin e Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave lidhur me Të me Shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* ("Aktakuza"),<sup>3</sup> ku, ndër të tjera, "kërko[i] caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës në lidhje me këtë fazë dhe të gjitha fazat e mëtejshme të procesit që burojnë prej kësaj aktakuze ose që kanë lidhje me të".<sup>4</sup>

## II. VENDI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

4. Duke marrë parasysh parashtrimet e Prokurorit të Specializuar, Kryetarja gjykon

---

<sup>1</sup> Marrëveshja midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës në lidhje me Vendosjen e Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë, 1 janar 2017.

<sup>2</sup> F00001, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 11 shtator 2023 (konfidencial).

<sup>3</sup> F00002, Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të me Shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 11 shtator 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

<sup>4</sup> Aktakuza, para. 5.

se situata aktuale e sigurisë dhe administrimi i duhur i drejtësisë e bëjnë të nevojshëm caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës. Ky ndryshim i vendit të procedurës ka të bëjë me procedurat e kryera në këtë çështje sipas nenit 38(4) të Ligjit, rregullës 86 të Rregullores, si dhe të gjitha procedurat dhe çështjet e tjera që burojnë lidhur me to. Kjo siguron zhvillim efikas, të efektshëm dhe të sigurt të këtyre procedurave.

### III. KLASIFIKIMI I VENDIMIT

5. Meqenëse ky vendim u referohet parashtrimeve të protokolluara të klasifikuara aktualisht si rreptësisht konfidenciale dhe hetimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, si dhe procedurat para Gjykatësit të Procedurës Paraprake vazhdojnë të jenë konfidenciale *ex parte*, ky vendim mban të njëjtin klasifikim. Vendimi aktual mund të riklasifikohet në një datë të mëvonshme, në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores, nëse arsyet për klasifikimin aktual pushojnë së ekzistuari.

### PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA

**VENDOS** që procedurat në këtë çështje të zbatuara sipas nenit 38(4) të Ligjit, rregullës 86 të Rregullores, si dhe procedurat e tjera dhe çështjet që burojnë në lidhje me to, të zhvillohen në shtetin pritës; dhe

**KËRKON** nga Administratorja që të marrë çdo hap të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,  
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 25 shtator 2023

Në Hagë, Holandë